



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:139863
Datë: 29.04.2024
Numri i dokumentit: 05637072

KPPP.nr.1532/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbartimore të kreditorit “IP-KOS” Sh.P.K., me seli në Graçanicë, Marigona Residence, Pennsylvania, Nr.41, pn, me NUI: 810834673, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “SCLR Partners” me seli të zyrës në Prishtinë, kundër debitorit “NOTI BETON” Sh.P.K., me seli në Obiliq, Llazarevë pn, me NUI: 810727563, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.409/22 të datës 12.05.2022, të nxjerrë nga Përmbartuesi Privat Flamur Bogaj me seli të zyrës në Prishtinë, jashtë seancës me datë 23.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET NË TËRËSI i pabazuar prapësimi i debitorit “NOTI BETON” Sh.P.K., i paraqitur kundër Urdhrit P.nr.409/22 të datës 12.05.2022, të nxjerrë nga Përmbartuesi Privat Flamur Bogaj, dhe i njejtë Urdhër MBETET NË FUQI në tërësi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, me Urdhrit Përmbartimor P.nr.409/22 të datës 12.05.2022, e ka caktuar përmbartimin ndaj debitorit në bazë të dokumenteve të besueshme–faturave dhe atë faturës Nr.GRINV-21-00002187 të datës 31.08.2021 dhe faturës Nr.GRINV-21-00001915 të datës 31.07.2021, me të cilin ka urdhëruar debitorin që t’ia paguaj kreditorit borxhin në vlerë prej

3,034.30 Euro, me kamatëvonesë prej 8 %, si dhe shpenzimet e procedurës, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Kundër urdhrin të Përmbaruesit Privat, brenda afatit të rregullt ligjor debitori ka ushtruar prapësim, me arsyetimin se lejimi i përmbarimit karakterizohet me shkelje të shumta dhe mangësi procedurale. Më tej ka theksuar se shkelje tjetër materiale që e bën urdhrin të papërmbarueshëm është edhe mosveprimi në bazë të nenit 30 të LPP-së, ngase në këtë çështje nuk ka pasur asnjë deklaratë që kredia e cila kërkohet nga kreditori është bërë e kërkueshme, dhe po ashtu i njejtë nuk ka përcaktuar as afatin paritiv për përmbushje vullnetare të detyrimit, ashtu siç përcaktohet edhe me nenin 27 par.1 të LPP-së. Ka shtuar se gjykata do të duhej ta merr parasysh edhe çështjen e mosvërtetimit të raportit kontraktual ndërmjet kreditorit dhe debitorit, pasi që në dosjen e propozimit për përmbarim kreditori nuk ka vërtetuar raportin kontraktual. I ka propozuar gjykatës që të pranohet në tërësi prapësimi i paraqitur nga debitori, si dhe të shfuqizohet plotësisht urdhri përmbarimor P.nr.409/22.

Kreditori, në përgjigje në prapësim konsideron se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar dhe se i njejtë është parashtruar vetëm sa për ta shtyrë këtë procedurë përmbarimore. Më tej ka theksuar se faturat të cilat janë dërguar në përmbarim e kanë afatin e skadimit, respektivisht afatin për pagesë, ndërsa sa i përket pretendimit se mungon raporti kontraktual mes palëve, kjo përbën çështje pa relevancë në procedurë përmbarimore. Ka shtuar se me asnjë dispozitë të LPP-së, nuk kërkohet që faturave tu bashkangjitet kontrata, e aq më pak kur faturat janë pranuar nga debitori, janë nënshkruar dhe vulosur nga i njejtë dhe asnjëherë nuk janë kundërshtuar nga debitori. I ka propozuar gjykatës që prapësimi të refuzohet në tërësi si i pabazuar dhe të mbetet në fuqi urdhri për përmbarim i Përmbaruesit Privat.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësim të debitorit, deklarimeve në përgjigje në prapësim të kreditorit, dhe pas analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe duhet të refuzohet në tërësi nga shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërkaq me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbarim po qe*

se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”.

Tutje me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në shkresat e lëndës është evidentuar se kreditori i ka bashkëngjitur propozimit për përmbarim dokumentet e besueshme faturën Nr.GRINV-21-00002187 të datës 31.08.2021 dhe faturën Nr. GRINV-21-00001915 të datës 31.07.2021, në origjinal dhe me të gjitha elementet përmbajtësore të cilat i përcakton LPP me nenin 29 dhe 37.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, është përcaktuar koha e përmbushjes së detyrimit monetar, të njëjtat janë dorëzuar në origjinal dhe janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, fakt i cili vërtetohet nga nënshkrimi i debitorit në këto fatura.

Andaj, bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së.

Nga sa u theksua më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit gjykata ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1532/23, me datë 23.04.2024

G j y q t a r i
Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Dhomën e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.